

BIBLIOTEKA
SHTETIT

FOTO MALO



LËDRAT
e ALBANËS


814-1-13
1924

BIBLIOTEKA E FATOSIT

FOTO MALO

LODRAT E ALBANËS

(Vjersha)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: Moisi Zaloshnja


Piktor: Dolli Gjinali

Tirazhi 8.000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1974



YLLKAT SHËMBËLLORE

Çeli kaçja, çeli vjollca,
U mbush kopshti çuna, goca,
Plot me yllka shëmbëllore,
Lulëkuqe, lulebore.

Lodërtarë, pastërtorë,
Ecin kapur dor' përdorë,
Hedhin valle në oborr.

Lozin, qeshin, hedhin valle,
Porsi lulet në livadhe,
Porsi yjet përmbi male:

— Ore, ore, lulebore,
Jemi yllka shëmbëllore,
Dallëndyshe në pranverë,
Trima të xhaxhit Enver.


ZOGU I VOGËL

Zog i vogël bukurosh,
Që po fle, që po fle,
Ti nuk di të fluturosh,
Ndaj rri në fole.

Fli të rritesh sa më shpejt,
Sa më shpejt, plot shëndet,
Të shëtitesh qiellin krejt,
Mal e fushë e det.

Dhe aher'kur të mësosh,
Të mësosh të fluturosh,
Nënë n kurr' mos ta harrosh,
Zogu vogëlosh!

Nëna jote aq e mirë,
Sa e mirë, sa e mirë!
Për ushqim shkon ndaj të gdhirë,
Shkon për ty, o bir.



Që të rritesh si ajo,
Larg të shkosh, lart të shkosh,
Krimba, vemje, mos lësh, jo,
Bimët t'i shpëtosh.

Të blerojë pylli ynë,
Malet tanë, toka jonë;
Zogj si ti të fluturojnë,
Këngë plot të thonë.

LODRAT TONA

Lodrat ne i duam shumë,
Pran'i mbajmë dhe në gjumë.
Që të bukura të mbeten,
I pastrojmë si dhe veten.

Në shtëpi Lilit një ditë
Ne i shkuam për vizitë.
Në çdo dhomë, në çdo anë,
Pastërta dhe rregull pamë.

Po një gjë nuk ishte mirë:
Kuklla kish dy ditë pa fshirë;
Pakëz pluhur kish mbi flokë.
Lili uli sytë përtokë.

Që të bukura të mbeten,
Lodrat t'i pastrojmë si veten.



NJË GJË E THJESHTË

Duke lojtur sot
Me çelësin e ri,
Dera u mbyll fort;
«Ç'të bëjmë tani?»

Babi jashtë mbeti
(«Babi, më ke xhan?»)
Lola brënda, vetëm,
Gati sa nuk qan.

Dera u mbyll fare,
Nga të dal un'vallë?
— Babi, në dritare
Shpejt vendos një shkallë!

Ngjitu merrëm mua! —
Thrret ajo nga lart.
Ah, sa u hutua
Çupa atë çast!



Dera hapet lehtë,
Lolë e vogël-o;
Shpejt nga ana tjetër
Çelësin rrotullo!

P U N Ë M A D H I

Prindët Lilos dje i thanë:
«Bli një shkrepse në dyqan!»
Lilua nuk u kënaq;
«Një kuti? Sa pak! Veç kaq?
— Unë dua, moj mama,
Të bëj punë të mëdha!

Pun' e vogël kjo për ty?
Mir' ahëre, na sill dy!

«Dy kuti mos janë pak?
Një për drekë, një për darkë,
Po për nesër në mëngjez?...»
Dhe ai, serbez-serbez:
«Duhet marrë tri kuti»,
Tha dhe bleu tamam tri.

«Solla tri!» thirri në prak;
«Një për drekë, një për darkë,
Një për nesër sa të zbardhë...»



— Ç'thua, more «punëmadh»!
Zjarri ndizet me një fije;
Kaq pak gjë si nuk e dije?!



KUKLLA DHE BUBI

— Pse nuk flet me gojë,
Moj kukull e bukur?
— Bubi sot në lojë
Flokët më ka ndukur.

— Bubi kërkoi ndjesë,
Pse me të s'pajtohesh?
Për këtë ti nesër
Ndoshta do pendohesh.


* * *

Kush atje matanë
Thrret e qan me kujë?!
Kuklla ra në banjë
Dhe u krodh në ujë.

Dhe për pak do mbytej,
Sikur Bubi drejt
Brënda të mos zhytej
Dhe ta nxirrte shpejt.



13378



BUKA NË ÇANTË

Në oborr sipër një muri
Çantën Lilua ç'e vuri
Dhe pastaj djersiu boll
Në lojlufte e futboll.

Ai lozte, po një pulë
Çak e çuk çantës iu sul. . .

Zilja ra, filloi mësimi,
Hapi çantën Lilo trimi.

Po ç'të shohë! Ja fletorja
Kish plot vrima, njolla, bojra;
Tok me bukën dhe me lyrën
Pula i kish ngrënë detyrën.



GJYSHJA DHE MBESA

— Mbesë moj, bijë moj,
Pse s'më the të të ndihmoj?

— Gjyshe, ti që di të qepësh,
Di të bësh dhe yll pesëcepësh?

— Atë yll që ti ke nisur
Un' në mal e kam qëndisur.

— Partizane ti ke qënë
Dhe gjë mua s'më ke thënë?!

* * *

Gjysh' e mbesë pak nga pak
Bënë yllin për merak.

Gjyshja tha një histori
Nga betejat për liri.

FLUTURA DHE XHAXHI ME SYZE

Flutura në tren kish frikë
Nga një xhaxhi me gjyslykë;
Prapa xhameve të trashë
Sytë dukeshin plot r Rathë.

Po kush tjetrin e gjykon
Veç nga pamja, keq gabon;

Xhaxhi qenkësh babaxhan,
Fluturën e mori pranë,
I tregoi dhe një përrallë
Për një trim me yll në ballë.

Xhaxhi trupin kish të fortë
Se stërvitur qe me sport,
Porse sytë kish të dobët,
Se, kur ishte çun i vogël,
Shpesh lexonte edhe shtrirë;
Libri nuk ndriçohej mirë.



As në bangë s'rrinte drejt;
Syri mjegullohej krejt,
S'i dallonte mirë gërmat;
Lulet dukeshin si gjembat.
Zogjtë se ku strukeshin;
Sendet qartë s'dukeshin.

...Por që sytë ne të mbrojmë,
S'domethënë mos lexojmë.
Të lexojmë, po me rregull,
Që në sy mos kemi mjegull.

NËNA E INËS

«Përse nëna
U vonua?»
Po pyet Ina
E shqetësuar.

I them unë:
— Prit, moj Inë;
Ka pak punë
Në uzinë. —

Po kjo Ina
Hiç nuk pret,
Tek uzina
Niset shpejt.

Në të hyrë
Në uzinë
Nëna kish
Fotografinë.



TË DALLUAR



Ina tha:
— Qënka vonuar;
Tek tabela
Ka qëndruar!



EDHE GONI TË KËNDOJË

Goni është fort krenar;
E ka babin këngëtar.

Këngëtar dhe Goni do
Që të bëhet, mirëpo

Të këndojë bukur s'di
Dhe pse «di» thotë ai.

Kur mes nesh Iliri vjen,
Këndon ëmbël, na pëlqen.

Ndaj Ilirin dëshirojmë
Vazhdimisht ne ta dëgjojmë.

Edhe Goni të këndojë,
Porse duhet të mësojë.

Të mësojë nga më i miri,
Nga babai dhe Iliri.

LETRA E ALBANËS

Alb'e vogël në Tiranë
Gjithnjë lodrat i mban pranë.

Ka një gjel e ka një patë,
Elefant me hundë të gjatë.

Ka plot lodra, e ç'nuk ka!
Veç një qengj të vogël s'ka.

Ndaj dje gjyshit kjo Albana
I çoi letër nga Tirana:

«Gjysh i dashur, në më do,
Një qengj t'vogël më dërgo.»

Gjyshi ëmbël u përgjegj:
«Në pallat rri dot një qengj?»



Ai do në mal të rrijë,
Breg më breg të blegërijë.

Eja, mbesëzë, në fshat
Të shëtisim shpat më shpat.»

Dhe dy qengja ky babush,
Në dru arre dhe në bush,
Po gdhënd bukur e buzëqesh:
«Do t'ja çoj Albës peshqesh!»



KUR ALBANA SHKOI NË FSHAT

Kur Albana shkoi në fshat,
Lozte me një qengj leshart'.

Një mëngjez, kur ra një shi,
Tha Albana «shih, pa shih!

Qëngji im u lag, do ftohet;
T'i çoj çadrën të mbulohet.»

Kështu tha, kështu veproi,
Por ai çadër s'pranoi.

Përse qëngji çadër s'desh
Ende Alba s'e merr vesh.

Dhe në shi dhe në tufan
Qëngjin leshi ngrohtë e mban.
S'e qull shiu, nuk mërdhin;
Këtë gjë duhet ta dimë.



SHIU BIE POSI DUSH

Shiu bie posi dush,
Plot me pellgje fushën mbush;
Për në lumë rend e zjen,
Kërkon rrugën, po s'e gjen.

Por në ara gruri pret
Që të rritet sa më shpejt,
Ndërsa uji që po rrjedh
E përmyt edhe e zverdh.

Ndaj me bel e me lopatë
Hapëm një kanal të gjatë
Dhe rrëkeja ujë shumë
Gjeti rrugën për në lumë.

Gruri ynë, grur' i ri
Do të rritet bukuri.

KECI LIBERAL

Qe një kec që lozte
Pllajave me bar,
Donte të kulloste
Nga shokët i ndarë.

Tufa e qortonte:
«Rri këtu, mos ik!
Larg nga shok'e shoqe
Ti je në rrezik!»

Po s'desh t'i dëgjonte
Keci, jo, aspak.
Ujku tej përgjonte
Ta shtinte në lak.


Nga strofka e ujqve
Rendi një agim
Një dhelpër bishtkuqe,
Mburri kecin «trim»:



«Ferrave ç'je futur?
Dil në mal si burrë!
Ujqit janë zbutur,
S'janë si dikur.

Ah, ç'kullota! . . Eja!
Ç'lule ka në mal!»
. . . Iku nga kopeja
Keci liberal.

Se ç'pësoi «trimi»
Shkrepave të shkretë
Ju tani e dini,
E kuptoni vetë.



PAS LOJËS

Ne shokun Taulant
E zgjodhëm komandant,
E zgjodhëm që në lojë
Ai të komandojë.

Dhe si mbaroi kjo lojë,
Të gjith'u bëmë njëlloj.

Por prapë ai thosh
«Ti rri këtu,
Ti shko përposh!
Ti bëj ashtu,
Ti bëj kështu!»

Ndaj ne u zemëruam,
Kapelen i rrëzuam.



VRAU LILUA NJË MIZË

Në dritare me një shtizë
Vrau Lilua një mizë.

Miza ra, po ra dhe xhami;
Ç'do të thotë tani mami?

Vrau një «trimi me fletë»,
Po nga vrima hynë dhjetë.

TRIMI PREJ LLASTIKU

(Përshtatje)

Lodrat në mëngjes
Ngritën një ndërtesë,
Po një derr në drekë
E rrëzoi me feçkë.


— Derr, pse na prish punë?!

— Kështu dua unë!

Sapo u bë natë
Lodrat pa shamatë
Shkuan te minderi
Ku gërrhinte derri.

Ky derkuc i prapë
Kish mbi vesh një tapë.

Me një grep ia kapën
«Fap» ia hoqën tapën.



Shpejt «trimoshi» ynë
Ra përdhe pa frymë.

Trimëria iku,
Se u shfry llastiku.



P E M A Q Ë K Ë N D O N

Ela vogëloshe
Rri dhe po dëgjon:
Pema gjelbëroshe
Sa çudi, këndon!

Zogjtë trumba-trumba
Po këndojnë në pemë;
I dëgjojnë çupa,
I dëgjojnë djem.

Por ja, Çimi ynë
Hyri në oborr;
Mbylli pakëz synë,
Zgjati njerën dorë...

Çimi me llastikë
Zogjtë ç'i qëlloi,
Ndaj ata shpejt ikën,
Kënga fluturoi.



VINI EMRAT SHPEJT NË VEND

(Imitim)

Një njeri pa mend një herë
Shihni ç'ngatresë ka bërë:

Pula me patkonj shin grurë,
Kali vezë na dhuron,
Lopa bën fole mbi drurë,
Zogu qumështin prodhon.

Ja bën macja «ga-ga-ga»,
Pata zuri goxha mi.
Ky këndezi kashtë ha,
Bën gomari «ki-ki-ki».

Vini emrat shpejt në vend,
Se kjo është'punë pa mend!

DHELPRA DHE IRIQI

Në një vresht me rrush e fiq
Takon dhelpra një iriq:

— O iriq, tha dhelpra, unë
Kam dëshirë të madhe shumë
Të të ledhatoj kurrizin,
Po ke gjemba dhe më grisin.

— S'ke ç'i bën, eh, jam gjëmbaç!
Ledhatomë kështu, në daç.

— Gjyshi yt dikur s'kish gjemba,
Ti përse je strukur brenda?

— Se yt gjysh, shekuj të shkuar,
Gjyshin tim ka ledhatuar.
Ne ahëre gjëmba s'kishim,
Ndaj me lot e qanë gjyshin.



Qysh ahere përmbi shpinë
Gjëmbat si mburojë mbinë.
Qysh ahere ne s'lejojmë
Bishat të na ledhatojnë.

DHELPA DHE RRUSHTË

Për në vresht' u nis një dhelpër
Që i donte rrushtë tepër.
Para vreshtit, në një anë,
Një tabelë sytë i panë:

«Mos i prekni, se hardhitë
U spërkaten¹⁾ këto ditë!»

— Shkruar bukur, s'ke ç'i thua;
Duan të ma hedhin mua! .

Kur dikur një pjergull pashë,
«Rrushi s'është pjekur», thashë.
Mirëpo njerëzit e këqinj
Thanë «S'mundi t'i arrijë,
Ndaj i shan si të pabërë...»

1) Spërkatur më ilaç për të zhdukur insektet e dëmshme.



MOS
I PREKNI!
AM SPÆRKATUR
AM

Po tani, he, he. . . të tërë
Do t'i ha, — tha dhe i hëngri,
Porse barku fort i dhëmbi.

Më e zgjuar nga njeriu
Desh të dilte, por e piu. . .

ELEFANTI DHE MIZA


Elefantit dje një mizë
I kërceu në kurriz.
Pastaj «zu-zu-zu» te veshi
T'i këndonte pakëz deshi:

— Nina-nana, elefant,
Fli të bëhesh ti gjigand,
Më truplarti përmbi dhe,
Madhështor sa një deve!

— Pse moj, më i madh s'jam vallë
Nga deveja kurrizdalë?

Po kjo miza «zu-zu-zu»,
E vazhdoi këngën kështu:

— Elefant, o elefant,
Fli të bëhesh ti gjigand
Sa xhirafa qafëgjatë!



— Ik, moj mizë, moz e zgjat!
— Ik, mos bëj të tilla gafa!')
Unë jam sa tri xhirafa!

Porse miza «zu-zu-zu»,
E vazhdoi këngën kështu:

— Elefant, o elefant,
Fli të bëhesh ti gjigand,
Rritu, bëhu sa një kalë!

— Hiqmu, mizkë! Ti çdo fjalë
Krejt së prapthi po e thua.
Gjithë bota më njeh mua:
Më gjigandi jam mbi dhe,
Më i madh nga çdo deve,
Nga çdo kalë dhe xhirafë;
Ik, se boll më re në qafë!

Mirëpo prapë «zu-zu-zu»,
Miza na vazhdoi kështu:

— Elefant, o elefant,
Fli të bëhesh ti gjigand,

1) gafa — gabime të rënda.

Madhështor ja, sa kjo mizë
Që ke sipër në kurriz!

— Gjersa rri mbi veshin tim,
Je e madhe, pa dyshim, —
Plot inat tha elefanti
Dhe hundën si pompë zgjati;
Një çurg ujë lëshoi si lumë:
Miza më nuk bëri zhurmë. . .

DËSHIRA JOTE

Ti ke kaq dëshirë
Të bëhesh piktor;
Me qymyr ke nxirrë
Shkallë, koridor.

Mureve, në derë,
Vija, njolla ka,
Patat që ke bërë
Bëjnë «ga-ga-ga.»

Kur ke kaq dëshirë
Të bëhesh piktor,
Merr një laps të mirë
Dhe një flet' në dorë.

Vizato një gjethe,
Lulen pak më larg,



Një katror, një rreth,
Një ylber me hark.

Kur të bësh shtëpinë,
Plot dritare hap;
Vizato çatinë,
Tymin mbi oxhak.

Nis e përdor ngjyrat:
Gjethen — me të blertë,
Diellin dhe fytyrat —
Me të purpur krejt.

Dil pastaj në rrugë
Ku makinat shkojnë,
Në veri e jugë
Plot prodhime çojnë.

Dil shiko kodrinat,
Fushat plot traktorë,
Shko nëpër uzinat
Mbushur me punëtorë.

Ngjitu nëpër malet
Plot me mineral

Dhe vështrimin ndale
Tej në det, mbi valë.

Gjithë bukurinë
Vizato me dorë.
Dhe kështu një ditë
Do bëhesh piktor.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Yllkat shëmbëllore	3
Zogu i vogël	5
Lodrat tona	8
Një gjë e thjeshtë	10
Punëmadhi	13
Kuklla dhe bubi	16
Buka në çantë	18
Gjyshja dhe mbesa	20
Flutura dhe xhaxhi me syze	22
Nëna e Inës	25
Edhe Goni të këndojë	28
Letra e Albanës	30
Kur Albana shkoi në fshat	33
Shiu bie posi dushi	35
Keci liberal	37
Pas lojës.	40
Vrau Lilua një mizë	42
Trimi prej llastiku	43
Pema që këndon	46
Vini emrat shpejt në vend	48
Dhelpra dhe iriqi	50
Dhelpra dhe rrushtë	53
Elefanti dhe miza	56
Dëshira jote	60